



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

**Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me numër 01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, për subvencionet në fushën e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Komuna e Podujevës shpallë:

**FTESE PUBLIKE**

PËR APLIKIM NË PROJEKTIN:  
**PËRKRAHJE ME FEFERONA**

**Përfitues:** 40 fermerë me nga 500 €

**Dokumentet e nevojshme për të aplikuar janë:**

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
2. Çertifikata e bashkësisë familjare
3. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë
4. Fletëposedimi (origjinal) për patundshmëri
5. Dokument zyrtar i cili dëshmon se aplikuesi është i pa punë

**Përparësit:**

**Poena**

- |                                                                                 |    |
|---------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar në ndonjë projekt në 3 vitet e fundit | 10 |
| 2. Aplikuesi që nuk është i punësuar                                            | 10 |
| 3. Fermerët të cilët janë kultivues të perimeve                                 | 10 |
| 4. Numri i antarëve të familjes (për çdo anëtar 5 poena)                        |    |

**Sqarim:**

- Fermerët aplikues duhet të kenë së paku 20 ari sipërfaqe me perimkulturë.
- Mbjellja e fidaneve duhet të jetë sipas kritereve agroteknike nga 10,000 deri 13,000 fidane në 20 ari.
- Pjesa tjetër e investimit të bëhet nga vetë fermerët.
- Përfituesit duhet të sjellin faturen e rregullt për blerjen e fidaneve të feferonave.
- Pagesa do të bëhet pas konstatimit të organit përkatës komunal pasi të jenë përmbushur të gjitha kriteret e kërkuara .
- Pas furnizimit me fidane dhe mbjelljes së tyre nga ana e përfituesit do të realizohet pagesa.
- Vlera maximale që do të paguhet është 500 € për një fermer.

**Koha dhe vendi i mbjelljes:**

- Mbjellja e feferonave duhet të bëhet në Pranverë.
- Kultivimi i feferonave do të bëhet në tërë teritorin e Komunës së Podujevës.

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyren e Shërbimit të Qytetarëve.

**Afati i aplikimit është deri me datë 11.04.2023, në ora 16:00**

**Nr: 12-320/01-0019695/23**

**Podujevë, 14.03.2023**



**Drejtori i BPZHR**

**Fatmir Rudari**

**Mars, 2023**